

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME SINAN RAMIĆ

Plemetinë | DatA: 8 tetor, 2025

Kohëzgjatja: 54 minuta

Prezent:

1. Sinan Ramić (I intervistuari)
2. Nenad Andrić (Intervistuesi & kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e parë

Nenad Andrić: A mund të na tregoni diçka për veten tuaj, familjen tuaj dhe vendin ku jeni rritur?

Sinan Ramić: Quhem Sinan Ramić, kam lindur në Çagllavicë, në familjen Ramić. Kam jetuar aty për 30 vjet, pastaj erdha në Plemetinë, ku kam jetuar në barakat e punëtorëve, afër termocentralit. Ato ishin baraka që komuna i kishte dhënë si strehim alternativ. Aty kisha një dhomë ku jetoja me gruan dhe fëmijët. Ishim të martuar edhe para se të vija në Plemetinë. Në vitin 1995 u largova nga Çagllavica. Nuk mund të jetoja më atje, kishim një shtëpi të vogël dhe familja ishte e madhe. Pastaj erdha dhe qëndrova për dy javë te familja e gruas, derisa përfaqësuesit lokalë serbë më gjetën një strehim alternativ dhe më dhanë një dhomë në baraka. Menjëherë pas kësaj fillova të punoja në ndërmarrjen komunale dhe përmes saj punoja edhe në termocentral. Përveç punës së rregullt, punoja edhe si punëtor me mëditje. Punonim në arat e misrit, fëmijët i çonim te vjehrrit dhe vjehrra që të kujdeseshin për ta, ndërsa unë dhe gruaja punonim për rrogë.

Nenad Andrić: Si do ta përshkruanit ndryshe jetën tuaj para luftës në Kosovë?

Sinan Ramić: Mirë. Në fillim kisha familjen time, kisha edhe hallën dhe fëmijët e saj, i vizitoja shpesh me gruan dhe fëmijët. Jeta ishte si jeta: romët punonin, secili kujdesej për jetën e vet, për shtëpinë e vet, për t'u siguruar ushqim fëmijëve. Nuk kishim pasuri, nuk mund të ishim të pasur. Punonja në termocentral dhe njëkohësisht edhe si punëtor me mëditje, aq sa të kishim bukë për të ngrënë. Kur mora dhomën në baraka, nuk kisha asgjë. Ishte një dhomë bosh. Vjehrra më dha një dyshek, dy qilima, një bataniye, dy pjata dhe tre-katër lugë. Kaq kisha.

Më vonë, shefi në punë ma huazoi një kamion që të shkoja në Çagllavicë dhe t'i merrja gjërat nga shtëpia e familjes: disa shtretër, disa jorganë, edhe disa enë të tjera. Ishte vetëm një dhomë, në baraka. Nuk kisha mundësi të tjera, për shembull të ndërtoja një shtëpi. Atëherë ishte shumë e vështirë, tani është më lehtë të ndërtohet. Tani mund të marrësh kredi dhe ta ndërtohet shtëpinë, më parë nuk mundesha. Do të duheshin tre apo katër vjet për ta ndërtuar një shtëpi. Nuk mund të blija as tokë për ndërtim. Pagat ishin të vogla dhe për këtë arsye mbetëm në baraka.

Nenad Andrić: A mund të na tregoni disa kujtime nga fëmijëria juaj?

Sinan Ramić: Ka shumë. Si fëmijë isha shok me të gjithë, sidomos në Çagllavicë. Aty nuk kishte shumë romë, shumica ishin serbë. Në hyrje të Çagllavicës kishte disa shtëpi shqiptare dhe mbaja kontakte me ta. Si i ri shkoja në shumë ahengje lokale; ata që më njihnin e dinin se isha rom, ndërsa ata që nuk më njihnin nuk mund ta dallonin kurrë se isha rom. Flas serbishten përkryer dhe shokët e mi serbë nuk më thërrisnin Sinan, por më jepnin emra të ndryshëm serbë si Siniša ose Dragiša. Vajzat nuk e dinin që isha rom. Isha një fëmijë i varfër, vetëm babai punonte dhe familja jonë ishte e madhe. Në shkollën fillore kisha nota pesëshe nga klasa e parë deri në të tetën. Fillova shkollën e mesme, një shkollë teknike profesionale në Prishtinë. Dhe për shkak të mungesës së mjeteve financiare, pas gjashtë muajsh e lashë.

Më duheshin para për biletën e autobusit, për të ngrënë, për të blerë rroba dhe ne thjesht nuk i kishim. Shokët e mi të shkollës nga Çagllavica më ndihmonin, por nuk mundnin ta bënin gjithmonë. Prapë dilnim bashkë në ahengjet lokale dhe aty askush nuk mund ta dallonte që isha rom. Një herë, në një nga këto ahengje, po bisedonim me disa vajza dhe njëres prej tyre i thashë që jam rom, ajo nuk më besoi. Me mua ishte një shok, sot mik i vjetër me të cilin flas edhe sot, ai është serb. I thashë: “Branko, hajde këtu.” Fola me të në gjuhën rome, vajza u habit dhe aty e pyeta se kush mendonte se ishte rom, shoku im Branko apo unë, dhe ajo nuk mund ta dallonte. Unë isha rom. Sa isha beqar, dilja shumë, nëpër dasma. Nuk ka vend në Kosovë ku të mos kem qenë në ndonjë dasmë: Gjilan, Prizren, Mitrovicë, Vushtrri, Janjevë, Lipjan, Prishtinë... Nuk kam nevojë ta përmend Graçanicën, ishte afër shtëpisë sime, kisha dajë dhe halla atje, edhe motra ime ishte martuar atje, familje e madhe.

Nenad Andrić: Kam dëgjuar një tregim se keni punuar si kamerier në Hotelin Grand në Prishtinë, a është e vërtetë?

Sinan Ramić: Jo, ishte vëllai im ai që punonte si kamerier në Hotelin Grand. Unë punoja në një kafene lokale në Çagllavicë. Aty fillimisht u punësova si zjarrfikës për kaldajën e ngrohjes qendrore, duke mbajtur zjarrin ndezur. Pas një kohe u avancova në banakier dhe nga banaku u avancova në kamerier. Kam qenë në atë botë për gati pesë vjet. Ishte nga viti 1985 deri në vitin 1990.

Nenad Andrić: Si ishte ajo puna juaj, a ju pëlqente?

Sinan Ramić: Ishte një lokal i vogël dhe si kamerier merrja shumë bakshishe, dhe si kamerierë duhej edhe t'i mashtronim pak njerëzit. Ai lokal kishte muzikë live çdo natë dhe unë kisha klientët e mi të rregullt; atyre nuk ua ndryshoja çmimin dhe ata më jepnin bakshishe të mira. Ishte punë e rëndë. Natën mund të ecje lirshëm nëpër rrugë dhe të mos kishe frikë nga asgjë apo askush. Unë punoja në lokal, vëllai im punonte në Prishtinë në hotel, dhe babai punonte në ndërtimtari. Kishim një jetë të thjeshtë, të varfër. Ishim të varfër, por të ndershëm. I gjithë fshati na njihte si fëmijët e Bajramit, të varfër, por të ndershëm.

Punonim me mëditje në fshat për një familje serbe. Ai burrë serb gjithmonë e thërriste babain tim “krushk”, sepse edhe gruaja e tij edhe nëna ime ishin nga Graçanica dhe kishin jetuar në të njëjtën rrugë, dhe na angazhonte të punonim në kopshtin e tij. Na linte çelësin e shtëpisë kur ai dhe gruaja ishin në punë. Gruaja e tij na linte ushqimin brenda dhe na thoshte që kur të kishim uri, të hynim në shtëpi dhe të hanim. Ata pyesnin pse unë nuk haja, dhe unë u thosha: “Nga respekti për shtëpinë tuaj.” Ishim të varfër, por të ndershëm. Diçka që edhe sot mund të shihet.

Këtu kam punuar edhe si punëtor me mëditje për serbët dhe ata janë shumë të kënaqur me mua. Kam pasur në dorë shumë nga paratë e tyre gjatë punës për ta dhe kurrë nuk u ka munguar asnjë cent. Më dërgonin të shkoja të merrja mall për dyqanet e tyre dhe udhëtoja me shumë para me vete, atëherë me tren, deri në katër mijë euro nga paratë e tyre. Vizitoja shumë kompani, blija mallin dhe madje ndihmoja edhe të tjerët që bënin të njëjtën gjë. Ata kurrë nuk kanë pasur mungesë të asgjëje dhe edhe sot e kësaj dite, disa serbë nga këtu ende punojnë në dyqanet e tyre, më lënë të kujdesem për traktorët e tyre, për shtëpitë e tyre.

Nenad Andrić: Si kanë jetuar romët dhe jo-romët së bashku menjëherë pas luftës, si ishin marrëdhëniet mes të gjithëve?

Sinan Ramić: Në fillim, menjëherë pas luftës, serbët dhe romët ishin këtu bashkë dhe silleshin mirë me njëri-tjetrin, ndërsa shqiptarët jo. Pse? Sepse menjëherë pas luftës, pasi u kthyen, nuk mund të dilje dhe të ecje lirshëm dhe nuk e dije se nga mund të vinin plumbat. Romët dhe serbët ishin bashkë, mbledheshin të gjithë, nëse kishte probleme me serbët, romët ndihmonin, nëse romët kishin probleme, ndihmonin serbët, i gjithë fshati mbledhej për t'i mbrojtur romët.

Me shqiptarët nuk kishim shumë kontakt pas luftës. Pse? Ndoshta sepse disa prej tyre kishin humbur babanë, nënën, motrën dhe kjo i kishte lënduar shumë. Tani jetojmë sikur të mos kishte pasur luftë, shkojmë lirshëm në Obiliq dhe në Prishtinë, blejmë ushqim atje dhe punojmë atje. Ka njerëz që punojnë në organizata shqiptare, ka edhe romë që punojnë atje. Ka shumë nga fëmijët tanë që punojnë në Lipjan në marketin Viva Fresh. Ata kanë transport të organizuar, rroga e tyre është 450–500 euro.

Është shumë ndryshe nga viti 1999. Deri në vitin 2003 ose 2004 nuk ishte aq mirë, prapë shkonim në Obiliq, por si? Vetëm nëse kishe një shok me makinë. Nëse nuk mund të flisje, thoshin: “Shiko, ja *magjupi*.” Sot shkojmë lirshëm në Obiliq, nëpër dyqane, hamë në restorante, blejmë furnizime dhe i marrim më lirë atje. Ata na shesin dru dhe qymyr për dimër. Nëse ke para, mund të blesh ushqim dhe dru. Na shesin edhe dru për zjarr me borxh ose me këste.

Nenad Andrić: Cilat festime, tradita dhe zakone kanë qenë të rëndësishme për ju dhe familjen tuaj? A ka pasur ndonjë dallim mes festimeve para luftës dhe tani?

Sinan Ramić: Po, para luftës, siç dihet, kishim Ederlezin¹, që është festa më e madhe e romëve. Edhe Vasin². Vasi është në dimër, njerëzit rrinin brenda, por shumica e romëve e festonin. Edhe Krishtlindjet, i festonim të gjitha festat. Por për Ederlezin, vishemi më bukur, blinim disa qengja, pije, dhe shkonim te lumi për të marrë degë shelgu. Shtëpinë e zbukurim me degë shelgu, rrinim zgjuar gjithë natën, çdo shtëpi kishte një radio të mirë, lëshonim muzikë festive me zë të lartë gjithë natën. Në mëngjes, grua ja çohet herët dhe i lante fëmijët me ato degë shelgu. Burri, si kryefamiljar, lahej i pari, pastaj therte qengjat, thërriste dikë për ndihmë nëse i duhej, ndonjëherë shkonte edhe te të tjerët për t'i ndihmuar në atë ritual. Kjo traditë u mbajt nga romët edhe pak pas luftës dhe pastaj, ngadalë, filluan të mos e festonin më Ederlezin, Vasin dhe të gjitha të tjerat.

Nenad Andrić: Pse ndodhi kjo?

Sinan Ramić: Shumë romë janë kthyer në Islam. Islami thotë se është haram të festohen Ederlezi, Vasi dhe festat e tjera, dihet që duhet të festojmë vetëm festat islame, si Bajrami i Ramazanit dhe Kurban Bajrami. Ende ka romë që e festojnë Ederlezin.

Nenad Andrić: Përmendët se muzika ishte gjithashtu një pjesë e madhe e traditës romë dhe, sa di unë, ju jeni edhe muzikant, luani tarabuka. Gjithashtu keni qenë pjesë e shoqërisë kulturo-artistike lokale?

Sinan Ramić: Po, quhej “Miloš Obilić”, ai serbi. U bashkova rastësisht. Askush nuk dinte të luante tarabukën. Askush nuk dinte të luante tarabukë, unë kisha luajtur më parë, por jo shumë, ndërsa vëllai im po, ai luante në bateri dhe tarabukë. Pse? Sepse nuk më interesonte. Por këtu shkova, më thirri drejtori im. Muzika popullore luhej në shkollë, më ftuan të ndihmoja dhe të pastroja dyshemetë pas provave. Shkova një herë, dy herë, tri herë... Ritmi më hyri në kokë. E pyeta koreografin nëse mund të luaja edhe unë. Ai më pyeti: “Çfarë?” “Tarabukë,” i thashë. Më tha ta merrja dhe të bashkohesha. Atëherë nuk e kisha instrumentin. I thashë se do ta gjeja. “Nesër është prova tjetër,” më tha, “dhe ti do të luash.”

Meqë nuk e kisha, çfarë të bëja? Ku ta gjeja tarabukën? Shkova te një rom tjetër këtu, te Hamiti, dhe e pyeta nëse kishte tarabukë, ai tha: “Po.” Atëherë e mora vetëm për një provë. Pas tri provave shkuam në një koncert në Velika Hoça. Edhe atëherë nuk kisha tarabukë. Shkova te Fatoni [një fqinj tjetër] dhe mora tarabukën e tij. Drejtori im tashmë e kishte thirrur dhe i kishte thënë që të ma jepte tarabukën derisa ta gjenim një për mua. Kur shkuam në Velika Hoçë, ishte hera ime e parë atje. Luajtëm dhe na

¹ Ederlezi (Herdeljez) është një kombinim i emrave të dy profetëve myslimanë, Hizirit dhe Ilyasit, të cilët takohen çdo 5 maj (Dita e Shën Gjergjit) për të mirëpritur fundin e dimrit. Është një festë e rëndësishme në të gjithë Ballkanin për komunitete të ndryshme.

² Vasi i referohet festës Bango Vassilii (e njohur edhe si Vasilyovden), një festë e madhe që kremtohet rreth Vitit të Ri, zakonisht më 13–14 janar, dhe që nderon një figurë çaluëse ose “të shtrembër” të quajtur Bango Vassil, mbrojtës mitik i popullit rom në legjenda. Festimi përfshin gostira dhe rituale të veçanta, me temën qendrore sakrificën dhe mirësinë që çuan në plagosjen e tij gjatë shpëtimit të popullit rom.

shkoi mirë dhe, kur u ktheva, ia ktheva tarabukën Fatonit. Pak më vonë shkova te vëllai im në Graçanicë, ai e kishte tarabukën e axhës sonë, ia shpjegova dhe ma dha. Ende e kam këtu. Luaja muzikë popullore, kishim koncerte këtu në Plemetinë, Graçanicë...

Nenad Andrić: A keni qenë edhe në vende të tjera jashtë këtu?

Sinan Ramić: Po, kam qenë, kemi qenë. Kam qenë në Jagodinë, Krushevac, Kopaonik, kam qenë në Beograd në emisionin “Žikina Šarenica”, po atë ditë ishim edhe në Obrenovac, kishte edhe atje disa koncerte popullore. Të nesërmen në mëngjes ishim në televizionin Pink, te Neša Ristić, ku edhe unë luajta. Kam qenë edhe në Republikën Srpska [Bosnjë e Hercegovinë], ku qëndruam katër deri në pesë ditë duke luajtur. Atje atëherë kishte një aksion vullnetar për dhurimin e gjakut. Aty dhurova gjak dhe u shpërbleva me një pllakë të artë dhe një medalje.

Nenad Andrić: Për sa dhurime jepet pllaka e artë, për 50?

Sinan Ramić: Ma dhanë sepse erdha nga Kosova, meqë ishim atje me folklor, më nderuan në atë mënyrë.

Nenad Andrić: A e dinin sa herë keni dhuruar gjak më parë?

Sinan Ramić: Deri atëherë kisha dhuruar gjak 60 herë.

Nenad Andrić: Pllaka e artë jepet për 50 dhurime?

Sinan Ramić: Jo, për 100.

Nenad Andrić: Atëherë si e morët me 60?

Sinan Ramić: Atje, në Republikën Srpska, në Bosnje, si shenjë mirënjohjeje.

Nenad Andrić: Pra deri tani, sa herë keni dhuruar gjak, 60 apo më shumë?

Sinan Ramić: Deri sot kam dhuruar gjak 120 herë.

Nenad Andrić: Mashallah, mashallah. Si arritët deri te dhurimi i gjakut?

Sinan Ramić: Është një histori e trishtë. Shumë e trishtë.

Nenad Andrić: A mund të na e tregoni historinë?

Sinan Ramić: Po, sigurisht. Motra ime ishte shumë e sëmurë dhe askush nuk donte të dhuronte gjak për të. Ajo ishte në spital në Nish. Kjo ishte në vitin 1991, 1992. Ju kam gënjyer, herën e parë dhurova gjak në vitin 1986, pastaj në mënyrë aktive nga viti 1993. Kishte edhe një rast me vajzën e axhës sime, ajo ndërroi jetë. Kur isha në ushtri, ajo vuante nga leucemia. Unë isha në ushtri, të gjithë dhuruan gjak për të, por nuk arritëm ta shpëtonim.

Isha në ushtri kur më erdhi një telegram. Po shërbeja në Lubjanë. Komandanti im ishte gjithashtu nga Çagllavica. Ai doli dhe më shikonte, tha: “Ramić.” Unë thashë: “Po, shoku komandant?” “Përgatitu,” më tha. Unë thashë: “Si? Nuk kam para për udhëtim, askush nuk më ka dërguar.” Ai tha: “Mos u shqetëso për paratë, vetëm përgatitu.” Në atë moment mendova se më kishte vdekur babai. Kështu mendova. Ai punonte në ndërtimtari [dhe mendova] se ishte dehur dhe kishte rënë nga skela. E pyeta oficerin: “A më ka vdekur babai?” Ai tha: “Jo, shko dhe përgatitu, duhet të shkosh në shtëpi.” U shtanga, nuk kisha para. Shokët e mi atje e dëgjuan që nuk kisha para, oficeri ua kishte thënë, dhe derisa u ndërrova me rrobat civile, ata mblodhën para për mua. E pyeta sërish oficerin: “Çfarë është? A ka të bëjë me babain tim?” Ai tha: “Jo, babai yt është mirë, por duhet të shkosh në shtëpi.”

U përgatita, mora paratë që m’i kishin mbledhur dhe ai më dha leje tetëditore. Shkova në stacion për të blerë biletën, por isha në Lubjanë. Në orën 15:30 kisha trenin, e mbaj mend sikur të ishte dje, në orën 08:00 të mëngjesit isha në Fushë Kosovë. Ushtarët atëherë nuk paguanin biletë për autobusin urban, kështu që shkova në Prishtinë. Nga Prishtina për në Graçanicë kisha autobus në orën 10:30, por atëherë nuk munda të prisja. Shkova direkt në shtëpi. E pashë babain gjallë dhe i pyeta: “Çfarë ka ndodhur?” Djali i axhës erdhi dhe më tregoi çfarë kishte ndodhur. Tha: “Gjuka është e sëmurë, na duhet gjak për të, prandaj ta kemi dërguar telegramin.”

Nuk e hoqa uniformën, atëherë ishim të lirë, kur Jugosllavia ishte ende një në vitin 1986. Shkova në Shkup. Shkova në spital dhe në atë kohë jeta e saj varej në një fije. Infermieret filluan një transfuzion të drejtpërdrejtë gjaku nga unë tek ajo, mjeku më shikonte dhe unë isha i veshur si ushtar. Gjaku rridhte ngadalë dhe unë isha aty për një orë, me një gjilpërë në venë. Mjeku rrinte pranë meje, duke matur tensionin, pulsën... E mbajti kështu derisa ajo i hapi sytë. Ajo ishte zgjuar për dhjetë minuta, ma hoqën gjilpërën dhe unë isha i zbehtë si fantazmë. Djali i axhës, që ishte aty me mua, kishte shumë para, ishte mirë ekonomikisht. Ai punonte në ndërtimtari, kishte punuar tre vjet në Libi dhe kishte gjithë paratë e botës. Më pyeti nëse kisha nevojë për diçka, nëse doja të haja diçka. I thashë të më sillte pak ushqim, pak verë të kuqe dhe një kavanoz me panxhar turshi.

Nga viti 1993 fillova të dhuroj gjak në mënyrë aktive. Motra ime ishte në shtratin e vdekjes. Shkova në Nish dhe atje desha t’i rrah disa mjekë. T’i çoja në gjyq. Pse? Ata po çuditeshin pse mbiemri im ishte Ramić dhe i saj Selimović. U thashë se ishte mbiemri i burrit të saj. Më kërkuan certifikatën e lindjes me mbiemrin e vajzërisë. “Ku ta gjej unë atë?” i pyeta. “Ajo është e martuar me burrin e saj. Unë jam Ramić, ajo është Selimović, ajo është motra ime.” Mjeku i dytë që erdhi më lejoi të dhuroja gjak, por prapë kërkonte certifikatën e lindjes. Sikur ishin të verbër që nuk e shihnin sa shumë i ngjanin

njëri-tjetrit. Kështu fillova të dhuroj gjak, kur pashë padrejtësitë që ndodhnin, jo vetëm ndaj motrës sime, por ndaj të gjithëve.

Nga viti 1993 punoja në Prishtinë në një kompani, Yugoplastika. Ajo prodhonte pjesë plastike për veturën Yugo. Thirrjet e hapura për dhurim ishin të rregullta, kështu që dhurova gjak për herë të parë. Pas kësaj fillova të shkoja rregullisht në institutin e transfuzionit për të dhuruar gjak. Dhe kur një herë fillon dhe mësohesh me këtë, nuk mund të ndalesh më. Tash e 32 vjet, në mënyrë aktive. Çdo tre deri në katër muaj. Këtu te Kryqi i Kuq kam marrë edhe dy medalje, pllaka, për herën e 35-të, pastaj për herën e 75-të. Tani në nëntor ose dhjetor, e kam harruar kur ma thanë, do të vijmë njerëz nga Beogradi, nga Kryqi i Kuq, dhe duhet të marr një çmim. Me shumë gjasë do të jetë financiar. Për 120 herë, në komunën e Obiliqit askush nuk ka dhuruar gjak më shumë se unë.

A mund ta pi një cigare?

Pjesa e dytë

Nenad Andrić: Si ka ndikuar lufta te ju dhe familja juaj?

Sinan Ramić: Frikë, bombardime nga njëra anë, askund për të shkuar, askund për t'u fshehur. Uleshim dhe nuk lëviznim, atëkohë jetonim në Plemetinë. Gjatë ditës ishte më lehtë, kishte më pak bombardime dhe të shtëna. Por natën ishte tmerr. Më së shumti kisha frikë për fëmijët e mi. Atëherë kisha tre fëmijë, dy djem dhe një vajzë. Edhe këtë e kaluam. Nuk po them se ishte gjithçka mirë, NATO bombardonte, ne i shihnim.

Nenad Andrić: Cilat ishin sfidat për ju dhe familjen tuaj gjatë luftës?

Sinan Ramić: Sfida më e madhe ishte kur shqiptarët erdhën në barakat e punëtorëve ku jetonim. Atëherë kishim frikë. Të gjithë ishin të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, erdhën në dhomën time dhe panë që nuk kisha vjedhur asgjë nga popullata shqiptare. Nuk kisha marrë asgjë. Pse? Sepse ishte mëkat ta bëje. Më thanë se gjatë luftës kisha qenë me uniformë, se isha ushtar. U thashë t'ia kontrollonin gjithë dhomën, ta shkatërronin nëse donin, dhe nëse gjenin ndonjë uniformë të ushtrisë apo policisë serbe, unë vetë do t'u dorëzohesha. Ata kontrolluan dhe shikuan gjithçka, dhe në fund më thanë se isha njeri i ndershëm. Nuk kisha aq frikë për veten time, sa për sigurinë e fëmijëve të mi.

It was a challenging time full of fear for both us and Serbs there. Where we lived there was a little store, a Serbian store, some 20 meters away from the main road. We were sitting there, having a few beers, me and my brothers, some local Serbs. Albanians passed and somebody shot a RPG into the little

store, but thank God it didn't go off. The initial blast broke the window. We all quickly ran outside, it didn't explode. People later gathered around, it was quite an incident. That was another challenge. Threats were only here while we were living at the workers' barracks.

Nenad Andrić: A kishte solidaritet ndaj jush nga anëtarët e komuniteteve të tjera gjatë luftës?

Sinan Ramić: Po, kishte, serbët ndaj romëve, po, ndërsa me shqiptarët jo. Pse? Sot situata është krejtësisht ndryshe. Dalim, shkojmë në Obiliq, blejmë atje. Nëse nuk dimë të flasim shqip, ata na flasin serbisht. Marr taksi për të shkuar për pazar. E thërras shoferin e taksisë, më çon atje dhe më kthen. Paguan dhe kaq.

Nenad Andrić: Cilat ishin problemet kryesore për romët menjëherë pas luftës?

Sinan Ramić: Romët e Plemetinës kishin frikë të dilnin nga Plemetina. Disa u larguan krejtësisht gjatë luftës, shkuan në Mal të Zi, si vëllai im. Edhe mua më thirrën të shkoja atje. Kisha mundësi të shkoja në Gjermani dhe të jetoja atje, por nuk shkova. Nuk shkova sepse as gruaja, as fëmijët e mi nuk kishin dokumente personale, vetëm unë. Nuk mund të shkoja vetëm, kush do të më merrte atje. Qëndrova këtu.

Jetoja në shtëpinë në cep të rrugës. Atje patëm një tjetër sfidë në vitin 2002, ajo shtëpi u dogj. Nuk isha në shtëpi kur ndodhi, isha jashtë duke punuar me mëditje për serbët lokalë. Duhej të punoja, nuk merrja rrogë të rregullt, kështu që duhej të punoja që fëmijët e mi të mbijetonin. Kur u ktheva atë ditë nga puna, pashë shtëpinë e djegur, mendova se edhe fëmijët ishin djegur. Falë Zotit, të gjithë ishin mirë. Pasuan edhe sfida të tjera. Na dhuruan disa tenda, në verë brenda ishte vapë përvëluese, por ia dolëm edhe me këtë.

Pas kësaj, serbët për të cilët kisha punuar atëherë, e blenë këtë tokë ku jetojmë tani. Në vitin 2004 u ktheva në punë të rregullt, në ndërmarrjen ku kisha punuar më parë, në Ndërmarrjen Komunale, dhe jetuam në një barakë të vetme që na ishte dhënë atëherë, atë që tani e përdorim si depo, mund ta shihni jashtë në oborr. Në vitin 2006, ish-kryetari i komunës serbe, ai që ndërkohë ka ndërruar jetë, më premtoi se do të më ndërtonte një shtëpi. Sa herë që shkonte në Beograd për të kërkuar ndihmë, rasti im ishte i pari në listë.

Romët si romë, disa fqinjë të mi më spiunuan, duke thënë se kisha kushte të mira jetese, se kisha familje jashtë që më ndihmonte, se nuk doja të blija tokë apo të ndërtoja shtëpi. Ia thanë edhe komisionit se të gjitha organizatat po më ndihmonin, se kisha vëllezër jashtë dhe se nuk më duhej shtëpi. Të gjithë ishin kundër meje, por nëse njeriu është i ndershëm dhe i drejtë, jeton jetën e vet, punon nga agimi deri në muzg për t'i siguruar fëmijëve jetesë, Zoti nuk e humb kurrë, kurrë.

Kishte romë që atëherë punonin në organizata dhe unë gëzohesha për ta. Njerëzit më pyesnin si mund të isha i lumtur për këtë. Unë u thosha: “Nëse është vullneti i Zotit, edhe unë do ta ndërtoj shtëpinë time.” Një ditë shtatori në vitin 2006 shkova në punë. Drejtori im atëherë më tha se kishte një arsye që unë t’i gostisja njerëzit në punë me ushqim dhe pije, por nuk e dija për çfarë bëhej fjalë. Më tha të shkoja në ndërtesën e komunës, sepse Dragan Trajković kishte kërkuar të më takonte. Shkova atje dhe Dragani më tha të njëjtën gjë, se atë ditë duhej t’i gostisja të gjithë. “Na sill pak lëng dhe disa biskota dhe do ta tregoj lajmin e mirë,” më tha.

Shkova në dyqanin lokal, pronari i të cilit ishte drejtori im në Ndërmarrjen Komunale, pasi gruaja e tij punonte aty. Edhe ajo më tha se sot ishte një ditë e veçantë për mua dhe përsëri isha i vetmi që nuk e dija arsyen. U ktheva në komunë me gostitë dhe ai ma prezantoi kontratën për ta nënshkruar, ishte kontratë për një shtëpi. Qaja aq shumë sa nuk mund ta nënshkruaja, dora më dridhej. Kur u ktheva, drejtori më dërgoi përsëri në dyqan me një Yugo, veturë të ndërmarrjes, për të blerë edhe më shumë gostitë për kolegët nga Ndërmarrja Komunale. Ajo ditë ishte pushim për të gjithë ne. Atë ditë hëngrëm dhe pimë. Kur filluan të vinin materialet e ndërtimit për shtëpinë tonë, unë i hapa themelet vetë me fëmijët e mi dhe vëllezërit erdhën të më ndihmonin. Kur fillova t’i ndërtoja muret, drejtori i dërgoi të gjithë kolegët tanë nga puna të më ndihmonin. Kishte disa serbë nga Prilujka, disa nga Plemetina, të gjithë ishin ndërtues me përvojë dhe edhe unë jam i tillë.

Vetë i bëra të gjitha punimet metalike për betonin e armuar. Kur erdhën serbët të më ndihmonin, brenda një jave shtëpia u përfundua. Kur arritëm te çatia, bëmë një festë të vogël. Madje mora edhe një muzikant, një djalë të ri nga vendi, që të na argëtonte. Një serb tjetër nga vendi, elektrikist me profesion, erdhi dhe ndihmoi me instalimet. Vëllai më ndihmoi ta përfundoja këtë dhomë dhe korridorin. Dyshemetë, tavanin, dyert dhe dritaret i vendosa vetë. I lyva dhe me kaq punët kryesore u kryen. Ndërsa unë dhe gruaja po shtriheshim për të fjetur në barakë, vendosa që atë natë të zhvendoseshim këtu, në këtë dhomë. Kishim një sobë të vogël, e vendosëm dhe ndezëm zjarr. Sollëm disa qilima, varfëri e vërtetë. Nuk kishim as shtretër, vetëm dyshekë. I sollëm edhe fëmijët këtu dhe atë natë nuk munda të flija. Në mëngjes shkova në punë dhe drejtori më pyeti si po shkonin punët rreth shtëpisë, i thashë se tashmë ishim futur në shtëpi, kështu që duhej të pinim edhe për këtë.

Tani është ndryshe. Gjashtë vjet më vonë ia shtuam edhe një dhomë shtëpisë, e rregulluam pjesën tjetër, jo 100%, por kishim mjaftueshëm për një jetë të qetë. Për gjashtë vitet e para pas ndërtimit të shtëpisë nuk kishim banjo, pastaj në vitin 2019 mora kredi nga banka për të ndërtuar një banjo në shtëpi. Pa kredi vërtet nuk mund të ndërtosh shtëpi. I kam ndërruar dyshemetë në të gjitha dhomat. Dhe po, komuna më ndihmoi përsëri, komuna serbe, në vitin 2019, më dhanë dritare dhe dyer të reja, si dhe materialet për izolimin e jashtëm të shtëpisë. Edhe komuna më ndihmoi. Për një kohë punoja, por tani na kanë mbyllur, kështu që rri në shtëpi. Nganjëherë na thërrasin për punë komunale, si pastrimi i varrezave, kur vdes dikush shkojmë dhe hapim varre. Kur vendoset një gur varri, më thërrasin edhe mua, unë i bëj punimet metalike.

Nenad Andrić: A mund të na tregoni cili është dallimi më i madh për ju mes kohës para dhe pas luftës?

Sinan Ramić: Shiko, ka dallim. Para luftës nuk kishte aq shumë shtëpi sa ka tani. Tani secili ka veturë, nuk ka familje rome pa veturë, disa madje kanë edhe dy vetura. Para luftës nuk ishte kështu. Para luftës, sa di unë, tre apo katër romë në Plemetinë kishin vetura: Medoja, familja e Dautit dhe e Mahmutit, Faiku që ti nuk e njeh, dhe Seferi që kishte një Zastava 128. Askush tjetër nuk kishte veturë. Pas luftës, romët filluan të kenë më shumë vetura. Ka një dallim të madh mes para dhe pas luftës. Tani romët marrin ndihmë sociale edhe nga Kosova edhe nga Serbia. Marrin ndihmë për lehonit dhe për fëmijë dhe askush nuk do të punojë më.

Nenad Andrić: Pra, ju keni punuar gjithë jetën dhe tani ka njerëz që thjesht nuk duan të punojnë?

Sinan Ramić: Nuk duan të punojnë. Kur punoja gjatë ditës në një hotel në Çagllavicë, prapë dilja të kërkoja një punë të dytë. Në pranverë shkoja të punoja me mëditje dhe mbillja patate për serbët lokalë. Pastaj vinte sezoni i qepëve. Pastaj sezoni i fasules dhe i misrit. Kur këto përfundonin, misri rritej dhe fillonte kultivimi i tij, dy herë. Pas kësaj, serbët e prisnin barin për sanë dhe na thërrisnin t'i ndihmonim ta mbledhim. Kur përfundonte sana, gruri ishte gati për korrje. Shkoja të korrja, ta ngarkoja grurin në thasë dhe fitoja para.

Sapo përfundonte korrja e grurit, mendoja se nuk kishte më punë, por pastaj vinte koha e korrjes së fasules. Fasulet i korrnim shumë herët në mëngjes, në orën 4. Atëherë bëhet. Kur përfundonte korrja e fasules, s'kishte më punë. Pastaj vinte vjeshta dhe korrja e misrit. Vetëm ata që nuk donin të punonin nuk kishin punë atëherë. Përveç gjithë kësaj, punoja edhe në ndërtimtari me djemtë e axhës. Ndërtonim shtëpi. Atë djalë e axhës që e përmenda, që ishte ndërtues, e ndihmoja t'i bënte kuzhinat, banjot, i përgatisja të gjitha materialet. Ai më mësonte si të vendosja pllakat.

Sot, shqiptarët vijnë dhe ofrojnë 50 euro në ditë për të punuar në arat me specat, që është pagesë shumë e mirë. Por askush nuk do të punojë. Shoh rreth meje në Plemetinë, dikë që nuk kishte bukë për të ngrënë, tani vozit veturë. Unë kam punuar gjithë këto vite dhe nuk mund të përballoj as një biçikletë. Pse? Sepse nuk ka. Kam rrogë të mirë, por kot, kreditë janë të rënda. Atëherë mora një kredi prej një milion dinarësh, por ende po e paguaj. Pastaj mora edhe një kredi tjetër në bankat e Kosovës, më duhej, po e rregulloja shtëpinë.

Nenad Andrić: Ngadalë arritëm të e sotmja, çfarë ju jep shpresë për një të ardhme më të mirë për romët në Kosovë?

Sinan Ramić: Vetë shpresa. Pa shpresë nuk do të isha këtu. Kam mundësi të shkoj të jetoj në Serbi, por qëndroj këtu. Pse? mund të pyesësh. E gjithë familja ime është këtu, vëllezërit e mi jetojnë në Graçanicë, unë jetoj këtu. Shoh romë përreth duke ndërtuar shtëpitë e tyre, duke shpresuar për një të ardhme më të mirë këtu. Jam edhe unë njëri prej tyre, edhe unë shpresoj. E kam ndërtuar atë që sheh,

jo shumë, por kam krijuar një jetë të dinjitetshme për veten, një jetë normale. Nuk jam aq i uritur sa të mos kem çfarë të ha e të pi. Ndoshta nuk kam mish për të ngrënë çdo ditë, por kam bukë.

Mund të lëviz lirshëm, kam qenë në Prishtinë qindra herë. Ec në sheshin kryesor deri te tregu i perimeve, ulem te Shabani dhe ha qebapët e tyre dhe kthehem në shtëpi. Askush nuk më thotë se kam sy të zinj. Ka shpresë, shpresoj të qëndroj këtu, që të ketë paqe mes shqiptarëve, serbëve dhe nesh romëve. Jo siç ishte më parë. Menjëherë pas luftës, nga viti 1999 deri në vitin 2003, për rreth katër vjet, shqiptarët kishin frikë të hynin në Plemetinë. Shqiptarët nga Plemetina po, por ata nga pjesë të tjera jo. Nuk flisnin me askënd, as me romë, as me serbë. Ngadalë kemi arritur në një pikë ku ata vijnë në oborrin tim dhe të lusin të blesh dru prej tyre. Në të gjitha këto unë shoh shpresë për një të ardhme më të mirë.

Nenad Andrić: Nëse do të mund t'u dërgonit një mesazh brezave të ardhshëm, jo vetëm romëve por të gjithëve, cili do të ishte?

Sinan Ramić: Jetoni, punoni dhe jini të drejtë e të ndershëm, ndershmëria fiton mbi gjithçka. Fitoni paranë me djersë, jo me gënjeshtër. Nëse dikush të punëson, shko, merr pagesën, por bëje punën me ndershmëri, që të vijë edhe herën tjetër dhe të të punësojë përsëri. Kam rastin e një ish-sekretareje në Ndërmarrjen Komunale, tani jeton në Nish. Çdo vit më thërriste të shkoja t'ia kositja barin në Prilukje. A nuk ka të tjerë që mund ta bëjnë? Po. Por ajo kishte parë tek unë një njeri të ndershëm dhe vetëm mua më punësonte. Çmimi kurrë nuk ishte problem. Kur më pyeste: "Sa?" unë i thosha: "Sa të duash të më japësh."

Ndershmëria fiton. Pa marrë parasysh, fëmijët e mi punonin te fermerë shqiptarë, punonin dhe sillnin në shtëpi paratë. Njëri nga djemtë e mi u sëmur dhe nuk e lashë më të punonte me mëditje. Paraja nuk mund t'ia blejë shëndetin. Ndershmëria është rruga, Nenad. I njëj Slavišën dhe Neškon, vëllezërit. Ata nuk do të ishin aty pa mua. Më besojnë aq sa të m'i lënë makinat dhe makineritë e tyre. Gjatë korrjeve vozisja traktorë, vetura, gjithçka që duhej. Ata më testuan, secili nga një herë. Në një nga dyqanet e tyre, në depo, Neško kishte lënë 1500 euro në dyshe dhe unë nuk e dija. Shkova në punë të nesërmen dhe pas kafesë së mëngjesit dhe një a dy rakive, më tha të sillja disa arka me verë nga depoja. Hyra brenda, i pashë paratë dhe i thashë vetes: "Ti mund të jesh i mençur, por unë jam më i mençur." I mora paratë dhe i futa në xhep.

U ktheva në dyqan, hapa një birrë nga frigoriferi dhe fillova të qeshja. Ai më pyeti pse, i thashë se dikush kishte humbur 1500 euro dhe unë i kisha gjetur, pikërisht aq sa më mungonin për të blerë tokë për ta ndërtuar shtëpinë. Ia thashë drejt në sy: "Ti je i mençur, por unë jam më i mençur. Merri paratë e tua dhe nëse më duhen para, do të të kërkoj." I thashë se isha rom nga Çagllavica, jo nga Plemetina. Më vonë më çoi në shtëpinë e tij, hapi kasafortën dhe më tha se nëse më duheshin para, mund të merrja sa të doja. I thashë jo. Edhe vëllai i tij, Slaviša, bëri të njëjtën gjë: e la portofolin në garazh me dokumente personale dhe para. E kërkoi dy ditë dhe nuk e gjente. Kur isha aty, e gjeta dhe ia ktheva pa

e hapur fare. I thashë se nuk kishte nevojë për teste të tilla dhe se po të më duheshin para, do t'ia kërkoja atij. Për shkak se i kalova ato prova, sot kam të drejtë të shkoj tek ata, të pritem dhe të nderohem, dhe të trajtohem me shumë respekt.